



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 74, datë 13.02.2023**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË  
VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM PËRCAKTIMIN E  
NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN), PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT  
2013-2016, PËR GJYQTARIN {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.02.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Yllka Rupa, dëgjoi gjyqtarin {...}, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...},

**VËREN:**

**I. FAKTET E ÇËSHTJES DHE PROCEDURA E ZHVILLUAR**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në parashikimet e nenit 85 dhe 97 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), nenit 25 të Ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016” dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, me vendimin nr. 239, datë 30.06.2022, ka vendosur fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit. Ndër gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit është edhe z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

2. Nëpërmjet këtij vendimi, bazuar në procedurën e shortit, për vlerësimin e gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016, është përzgjedhur relatore znj. Yllka Rupa dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin znj. Esmerilda Habili. Në datë 30.06.2022, bazuar në nenet 85 dhe 89 të Ligjit për Statusin, i është njoftuar gjyqtarit vendimi për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi) dhe emrat e vlerësuesve, nëpërmjet postës elektronike. Në datë 04.07.2022 gjyqtari ka konfirmuar marrjen e njoftimit dhe ka deklaruar se është dakord me vlerësuesit.

3. Nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin, bazuar në parashikimet e nenet 24, të vendimit nr. 197, datë 11.06.2020 “Rregulla për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, ka hartuar procesverbalin për pasqyrimin e çështjeve dhe vendimeve që janë pjesë e dosjes së rivlerësimit.

4. Në vijim të procedurës së vlerësimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dosjes së përcjellë nga organet e rivlerësimit kalimtar dhe dokumentacionit të dosjes personale të gjyqtarit, ka rezultuar se :

4.1 Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr.5, datë 24.07.2020 pasi ka parashtruar dhe analizuar të gjitha burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtarit, ka konkluduar lidhur me këtë kriter vlerësimi: *“Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si vijon:*

- në 4 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta në gjykimin e çështjes;
- në 2 raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin.

*Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thelloj në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumentimeve si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penale dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij”.*

4.2 Për këto arsye Trupa Gjykes e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ka vendosur:

1. *Pezullimin nga detyra të z.{...} për një periudhë një vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.*
2. *Në përfundim të këtij trajnimi, pas administrimit të rezultateve të arritura nga subjekti, Komisioni do të përfundojë procesin e rivlerësimit bazuar mbi të tri kriteret e vlerësimit.*
3. *Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe Shkollës së Magjistraturës brenda 30 ditëve pas kësaj seance dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr.84/2016.*
4. *Ky vendim është i paankimueshëm, bazuar në pikën 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

4.3 Pas administrimit të rezultateve të provimit përfundimtar të subjekti të rivlerësimit në mbarim të programit të trajnimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 444, datë 16.09.2021, pasi ka parashtruar dhe analizuar të gjitha burimet e vlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë, figurës dhe aftësitë profesionale të gjyqtarit, ka konkluduar: *“Trupi gjykes i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se: 1.*

*subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; 2. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; dhe 3. subjekti, bazuar në shkresën e Shkollës së Magjistraturës, rezulton se ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjeluar mangësitë e konstatuara nga Komision”.*

5. Pas konstatimeve si më sipër, KVEVP në mbledhjen e datës 12.01.2023 ka shqyrtuar propozimin e relatores së procedurës së vlerësimit dhe ka vendosur të miratojë propozimin për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, të filluar ndaj gjyqtarit {...}, duke ia kaluar për shqyrtim çështjen Mbledhjes Plenare.

6. Në datën 23.01.2023, nëpërmjet postës elektronike, gjyqtarit i është njoftuar relacioni mbi projektvendimin “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për gjyqtarin {...}”, duke iu njoftuar njëkohësisht: (i) e drejta për të paraqitur kundërshtime/shpjegime me shkrim dhe (ii) e drejta për t’u dëgjuar në Mbledhjen Plenare të Këshillit, duke iu komunikuar data dhe ora e zhvillimit të mbledhjes.

7. Në datën 26.01.2023, gjyqtari konfirmoi marrjen dijeni, si dhe parashtrori se kishte kundërshtime dhe shpjegime lidhur me projektvendimin, duke shprehur dhe vullnetin për t’u dëgjuar para Mbledhjes Plenare të Këshillit.

8. Gjyqtari morri pjesë në Mbledhjen Plenare të datës 13.02.2023, ku në mbështetje të qëndrimit të tij, parashtrori si vijon:

*8.1 Projektvendimi konsiston në referimin që i bëhet vendimit nr.5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është një vendim i ndërmjetëm, ku nga ana e këtij komisioni unë jam pezulluar nga detyra dhe më është dhënë detyrimi për të ndjekur programet e pranimit pas kurrikulës të bërë nga Shkolla e Magjistraturës, detyrim i cili është përmbushura nga ana ime, ku unë jam vlerësuar “Mirë”. Në përfundim të këtij rivlerësimi me vendim përfundimtar, unë si subjekt rivlerësimi me vendimin 444, jam konfirmuar në detyrë. Vendimi nr.5 ka çmuar se subjektit {...} ka shfaqur njohuri dhe aftësi në gjykim të ceket në punën profesionale, si vijon: (i) në ka 4 (katër) raste komisioni ka konstatuar se subjekti ka treguar njohuri dhe aftësi të cekta në gjykimin e çështjes dhe (ii) në 2 (dy) raste nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin.*

*8.2 Dua t’i bëj me dije këtij Këshilli se në 4 (katër) rastet që konstatohen / evidentohen nga ky komisioni në vendimin nr.5 nuk i përkasin periudhës 2013-2016. Të gjitha këto raste janë para kësaj periudhe. Pasi Komisioni ka hyrë që nga viti 2055, 2006, 2007 e me radhë. Për mua është hera e tretë që vijë para një Këshilli, dy herë nga ish-KLD dhe në 2 (dy) raste jam vlerësuar “Shumë mirë” nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pra, këto 4 (katër) raste nuk i referon vendimeve të periudhës 2013-2016.*

8.3 Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka qenë efektiv pasi ka zvarritur procesin. Dua t'ju bëj me dije se në këto 2 (dy) raste unë nuk kam qenë kryesuesi i trupit gjykues, kam qenë anëtarit i trupit gjykues, siç unë ja kam bërë me dije edhe Komisionit. Megjithatë ai ka qenë një vendim i tij, i paankimueshëm. Pra, vendim i ndërmjetëm për pezullimin është i paankimueshëm, parashikuar nga Kushtetuta, në Aneksin e saj. Në përfundim unë jam rivlerësuar për të tre elementet, pastërtinë e figurës, etik edhe profesionale, si dhe pasurinë, dhe nuk e shikoj pse është e pamundur.

8.4 Po ashtu, duke ju referuar nenit 77 të ligjit për statusin e gjyqtarëve, burimet e vlerësimit, vlerësimi i magjistratit bazohet në këto burime e me radhë nga germa "a" e deri tek germa "gj". Në asnjë rast nuk thuhet që si burim vlerësimi është edhe vendimi i ndërmjetëm i KPK-së. Nuk janë pjesë e burimit të vlerësimit, në këtë dispozitë që thuhet. Kështu që nuk shoh ndonjë pamundësi pasi statistikat janë, vlerësimet e mia të mëparshme janë, dosjet janë aty, vendimet i gjithë aktiviteti im është i mundur për t'u vlerësuar.

## II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

9. Neni "Ë" i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon: "Komisioni ose Kolegji i Apelit në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast vendimi jepet i arsyetuar. 2. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë".

10. Neni 58 i Ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", lidhur me masat disiplinore parashikon: "1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: a) konfirmimin në detyrë; b) pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës; c) shkarkimin nga detyra". Ndërsa neni 60 parashikon: "1. Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1-vjeçare i jepet subjektit të rivlerësimit nëse janë evidentuar mangësi në aftësitë e tij profesionale që mund të plotësohen...".

11. Në nenin 45/1 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, lidhur me vlerësimin për magjistratët të cilët do të ndjekin për një vit Programin e Formimit Fillestar, bazuar në vendimin e institucioneve të rivlerësimit përcakton se: "Në kuptim të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", subjektet e rivlerësimit të cilët janë pezulluar nga detyra dhe kanë detyrimin të ndjekin programin njëvjeçar të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, në përfundim të vitit të parë akademik vlerësohen nga rezultatet e

provimit përfundimtar, i cili do të përfshijë rezultatin e vlerësimeve në lëndët të cilat do të zhvillohen gjatë vitit të parë teorik (60% të vlerësimit të përgjithshëm) dhe një provimi me raste praktike (40% të vlerësimit të përgjithshëm), të cilat do të jenë në funksion të drejtimit të tij dhe mangësive të shprehur amë vendim nga institucionet e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit do të zhvillojë provimin me rastet praktike vetëm në rast se arrin të marrë një vlerësim të paktën “mjaftueshëm“ në provimin e secilës lëndë”.

12. Neni 171, pika 5 i Ligjit për Statusin, parashikon: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës”.

13. Neni 97, pika 3 i Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, parashikon: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”. Ndërkohë në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

### III. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

14. Gradimi i gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, për periudhën vlerësimit 2013-2016, mbështetet në përcaktimet e nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin në të cilin parashikohet se: “5. Pas vlerësimit të aftësive profesionale, të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ose Kolegji i Apelimit, në rast se është ushtruar e drejta e ankimit, i dërgon Këshillit dosjen me vlerësimin e kryer të magjistratit, çdo dokument të përdorur në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe vendimin e formës së prerë të procesit të rivlerësimit. Nëse magjistrati kalon me sukses procesin e rivlerësimit, **Këshillat vazhdojnë të bëjnë vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve, në zbatim të ligjit, për aq sa është e mundur, me qëllim që të përcaktojnë gradën e vlerësimit përkatës**”. Në referim të këtij neni, analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Referuar kuadrit ligjor si më sipër, në kushtet kur rezultoi se për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përbën periudhë të plotë vlerësimi, në kuptim të nenit 84 dhe 171/5 të Ligjit për Statusin, gjyqtarit {...} i është dhënë masa disiplinore e pezullimit nga

detyra për një vit dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit për një periudhë 1-vjeçare për shkak të evidentimit të mangësive në aftësitë e tij profesionale, procedura e vlerësimit etik dhe profesional të filluar për periudhën 3/vjeçare që përfshin vitet 2013-2016, nuk mund të vazhdojë.

16. Me vendimin nr.20, datë 15.07.2021 të Këshillit Pedagogjik dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës gjyqtari është vlerësuar “*se ka arritur rezultate të mira*” duke i kaluar mangësitë e konstatuar në vendimin e ndërmjetëm nr.5, datë 24.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Shkolla e Magjistraturës, në funksion të mangësive të konstatuar nga organet e rivlerësimit ka vlerësuar gjyqtarin në përfundim të vitit të parë akademik dhe që i përket vitit 2021.

17. Në ligjin nr.96/2016 nuk ka një parashikim të shprehur për përfundimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional pa vendim përfundimtar, ndërkohë që në nenin 7 të vendimit të KLGJ-së nr.263, datë 21.11.2019, parashikohet vetëm përfundimi pa vendim përfundimtar i procedurës së vlerësimit në rastet e mbarimit të statusit të gjyqtarit. Pavarësisht se në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara nuk ka një përcaktim të shprehur që rregullon situatën faktike në fjalë, në zbatim të nenit 97 pika 3 të Ligjit 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, Këshilli zbaton K.Pr.Administrative, në nenin 95 të së cilit parashikohet se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”.

18. Në rastin konkret, në kushtet kur gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016, në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, është vlerësuar nga organet e rivlerësimit kalimtar me mangësi, procedura e vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin), nuk mund të vazhdojë, pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit.

#### **IV. LIDHUR ME PARASHTRIMET E GJYQTARIT**

19. Gjyqtari {...}, pasi është njohur me relacionin e përgatitur nga relatorja, në të cilin analizohen faktet e çështjes dhe ligji i zbatueshëm, së bashku me propozimin për përfundimin e procedurës së vlerësimit pa vendim përfundimtar, për shkak se objekti i saj është i pamundur, në seancë para Mbledhjes Plenare në të cilën mori pjesë personalisht, ka paraqitur kundërshtimet e tij, të cilat evidentohen në paragrafin 8 të këtij vendimi. Lidhur me këto pretendime, përveç sa u analizua më sipër në kuadër të analizës ligjore të çështjes, duke iu referuar prapësimeve konkrete të gjyqtarit, Këshilli vlerëson si më poshtë:

19.1 Këshilli në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve dhe në tërësi në përmbushjen e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, ka në vëmendje të posaçme respektimin dhe zbatimin e njëjtë të ligjit ndaj të gjithë gjyqtarëve. Në rastin konkret, përfundimi i procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013-2016 për gjyqtarin {...}, është pasojë e mungesës së kushteve ligjore për

vijimin e kësaj procedure të filluar, në bazë të parashikimeve të nenit 171, pika 5 të Ligjit për Statusin. Ky nen, sikurse u analizua në paragrafin 14 të këtij vendimi, parashikon vijimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional, pas përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, por duke përcaktuar se kjo procedurë me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) të gjyqtarit, zhvillohet nga Këshilli, **vetëm nëse ky vlerësim është i mundur.**

19.2 Në procesin e gradimit, Këshilli bazohet në aktet e përcjella nga Komisioni i Pavaruri i Kualifikimit. Procedura e përcaktimit të nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (Gradimi) mund të bëhet vetëm për gjyqtarët që arrijnë nivelin minimal profesional. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendim të formës së prerë ka konkluduar se gjyqtari nuk arrin nivelin minimal profesional, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila mund të shtrihet që nga janari 2006, sipas ligjit, Këshilli nuk mund të bëjë vlerësim me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit.

19.3 Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për dhënien e masës disiplinore, për pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me detyrimin për trajnim, referuar pikës 2, të nenit F, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është i paankimueshëm, dhe si i tillë nuk mund të vihet në diskutim. Për këtë arsye Këshilli nuk mund të bëjë një përcaktim të ndryshëm të nivelit të vlerësimit për gjyqtarin, kur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në vendimin e tij të formës së prerë, ka konstatuar se gjyqtari nuk arrin nivelin minimal profesional. Këshilli përcakton nivelin e vlerësimit të gjyqtarit, duke rikonsideruar të dhënat lidhur me vlerësimin e gjyqtarëve, vetëm në ato raste kur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendim të formës së prerë ka konkluduar se gjyqtari ka arritur nivelin minimal profesional.

19.4 Nëse gjyqtari arrin nivelin minimal profesional, Këshilli kur bën gradimin, merr si burime vlerësimi të gjitha aktet e dosjes së vlerësimit profesional të dërguar nga organet e rivlerësimit, pjesë e të cilit janë edhe vendimet e ndërmjetme e ato përfundimtare të këtyre organeve. Gradimi si proces fillon nga Këshilli vetëm në rastet kur nga organet e rivlerësimit konkludohet se gjyqtari arrin nivelin minimal profesional. Analiza dhe konkluzionet e vendimit të formës së prerë të organeve të rivlerësimit kalimtar, konsiderohen të plota në lidhje me burimet që janë analizuar në kuadër të këtij procesi, vetëm në drejtim të qëllimit të identifikimit të gjyqtarëve që kanë arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Shkalla e kësaj aftësie në nivelet : “shkëlqyeshëm”, “shumë mirë”, “mirë” apo “mjaftueshëm” përcaktohet në procesin e gradimit, pavarësisht konkluzioneve të organeve të vlerësimit lidhur më të. Nëse nga organet e rivlerësimit sikundër në rastin konkret, konkludohet se gjyqtari pavarësisht vlerësimeve të mëparshme që ka pasur, nuk arrin nivelin minimal profesional, prandaj ai duhet të pezullohet nga detyra e t’i nështrohet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës, qëllimi i gradimit është i pamundur të realizohet. Kompetencën kushtetuese për të konkluduar nëse gjyqtari për periudhën e rivlerësimit 2013-2016, që në rastin konkret rezulton e shtrirë që nga janari 2006, e arrin apo jo nivelin minimal profesional, e ka Komisioni i Pavarur i Kualifikimi. Vendimi i ndërmjetëm i këtij të fundit, për zbatimin e masës disiplinore për pezullimin nga detyra me detyrimin për të

ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, është i paankimueshëm e i formës së prerë. Si i tillë ai nuk mund të rishqyrtohet nga Këshilli.

19.5 Sa më sipër, rezulton se pretendimet e gjyqtarit {...}, parashtruar në mënyrë verbale në Mbledhjen Plenare të zhvilluar në prezencë të tij, nuk rezultojnë të bazuara.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a” dhe “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 61 pika 1, 63 dhe 86 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263 datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**

1. Përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për shkak se vijimi i saj rezulton i pamundur pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**